



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1433/8 prot

Datë 22.10.2021

V E N D I M

Nr. 795/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2021 me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit me Nr. REF-01814-07-28-2021 me objekt: *“Studim-projektim “Punime ndërtimore dhe infrastrukture në varrezat publike Sharrë dhe Tufinë”*, me fond limit 1 249 958,6 (një milion e dyqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë presje gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale.

Ankimues: “Studio Services K-SA” SHPK
Lagja 3, Rr. “Ramazan Jella”, P.1125, K 1, Durrës

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Shërbimeve Funerale
Rr. “Durrësit”, nr.132, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.07.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Shërbim konsulence”, me Nr. REF-01814-07-28-2021 me objekt: “Studim-projektim “Punime ndërtimore dhe infrastrukture në varrezat publike Sharrë dhe Tufinë”, me fond limit 1 249 958,6 (një milion e dyqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë presje gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale.

II.2. Në datën 03.08.2021 operatori ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Njëpërmjet shkresës nr. 467/14 prot datë 06.08.2021 protokolluar me tonën me nr. 1433/2 prot., datë 09.08.2021 me objekt: *“Dërgim vendimi nr.prot., 467/13, datë 06.08.2021 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”* dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues *“Studio Services K-SA” SHPK* dhe me vendimin nr. 467/13 prot., datë 06.08.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka pranuar pjesërisht pretendimet e ankimuesit si vijon:

Ankimuesi pretendon se: *“Autoriteti kontraktor duhet të paraqesë sa metra katrorë është objekti magazinë”*.

Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton se kjo pikë e ankësës është pranuar si vijon:

“Pretendimi i tretë i firmës: Autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur përmasat e magazinës.”
Nga verifikimi i dokumenteve të tenderit, në shtojcën nr.10 *“Formulari i termave të referencës”*, *“Detyra e Projektimit”*, pika 1 *“Informacion i përgjithshëm”*, pika 4, përcaktohet se:

“Objekti i studim-projektimit do të jetë:

1. *“Magazinë 1 kat” në sektorin e varrezave publike Tufinë”, do të ndërtohet duke shfrytëzuar në mënyrë maksimale territorin ekzistues me të gjitha parametrat e nevojshëm të një magazine në mënyrë që të plotësojë nevojat e sektorit të varrezave Tufinë, për zhvillimin në kushte normale të punës, duke respektuar kriteret teknike të projektimit, standardeve dhe ligjeve në fuqi.*

Në detyrën e projektimit, pika 3, *“Kërkesat e projektit”*, pjesa *“Fleksibiliteti”* përcaktohet se: *“Lartësia minimale e magazinës (dysHEME-tavan e përfunduar) duhet të jetë 4.5 m.”*

Në detyrën e projektimit nuk rezulton të jenë dhënë përmasat e plota të objektit magazinë. Autoriteti kontraktor njëpërmjet një shtojce duhet të japë përmasat e plota të objektit magazinë.

Për sa parashtruam më lart, pretendimi i ankimuesit për këtë pikë qëndron.”

II.6. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 473/2021, datë 12.08.2021 ka vendosur:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me Nr. REF-01814-07-28-2021 me objekt: “Studim-projektim ”Punime ndërtimore dhe infrastrukture në varrezat publike Sharrë dhe Tufinë”, me fond limit 1 249 958,6 (një milion e dyqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë presje gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale.*
2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Me shkresat nr. 1433/5 prot., datë 01.09.2021 dhe nr. 1433/6 prot., datë 14.10.2021 me lëndë “Kërkesë për interpretim”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke kërkuar interpretim në lidhje me përfshirjen në pagesa e Audituesit të Energjisë, që kryen auditimin e energjisë dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë, në strukturën e kostos së projekt-idesë përfundimtare sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016.

II.8. Me shkresën nr. 6506/1 prot., datë 18.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1433/7 prot., datë 19.10.2021 “Kthim përgjigje”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin ku ndër të tjera ka informuar se: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me detyrimet e saj sipas Paketës së Tretë të Komunitetit të Energjisë dhe si pjesë e objektivit strategjik të Shqipërisë, ka harmonizuar legjislacionin e saj në kuadrin ligjor të BE-së për të krijuar përgjegjësi të qarta dhe transparente për zbatimin e acquis-ve të BE-së, ka miratuar aktet e nevojshme ligjore në fushën e energjisë, si më poshtë:

- Ligji Nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”, i ndryshuar dhe ligji Nr. 116/2016 “Mbi performancën Energjitike të Ndërtesave” ofruan bazën për krijimin e një strategjie të re për Efikasitetin e energjisë në Shqipëri dhe për ngritjen e kuadrit rregullator;
- U miratua Plani i Dytë dhe i Tretë Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë (PKVEE), (2017-2020);
- Në vitin 2016 u krijua Agjencia e Efikasitetit të Energjisë (AEE), e cila u bë funksionale në vitin 2017;

Në këtë kuadër, MIE në bashkëpunim me Agjencinë e Efikasitetit të Energjisë ka hartuar legjislacionin sekondar për impelmentimin e masave të efikasitetit të Energjisë si më poshtë:

- VKM Nr. 537, datë 08.07.2020 “Për kriteret minimale të performancës së energjisë në ndërtesa”;
- VKM Nr. 256, datë 27.03.2020 “Për metodologjinë për llogaritjen e niveleve optimale të kostos për kërkesat minimale të performancës së energjisë të ndërtesave”;
- VKM Nr. 958, datë 02.12.2020 “Për procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës energjitike të ndërtesave dhe modelin, përmbajtjen, kushtet e regjistrimit të “Certifikatës së performancës së energjisë” të ndërtesave përkatëse”;
- VKM Nr. 934, datë 25.11.2020 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe shumën e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesin e mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa”;
- VKM Nr. 1049, datë 24.12.2020 “Për Metodologjinë Kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa”;
- Certifikimin e menaxherëve energjitikë me VKM Nr. 342, datë 22.05.2019;
- Certifikimin e audituesve me VKM Nr. 407, datë 19.06.2019;
- Urdhër Nr. 05, datë 12.01.2021 “Për formatin e auditimit energjitik dhe pagesën e audituesit energjitik”.

Referuar kërkesës tuaj nëse është përfshirë pagesa e audituesit të energjisë që kryen auditimin dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë në strukturën e kostos së projekt-idesë sipas VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” duke qenë se baza ligjore e certifikimit të audituesve të energjisë, miratimi i formatit të auditimit energjitik dhe pagesës për audituesit për ndërtesat në fazë projekt-ideje dhe atyre të ndërtuara, janë miratuar në një kohë të mëvonshme si dhe duke patur parasysh se implementimi i tyre ka filluar në vitin 2021, ju informojmë se këto risi legjislative nuk kanë qenë parashikuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016. Për sa më sipër, sjellim në vemëndjen tuaj që aktet e sipërcituara, të miratuara në fushën e efikasitetit të energjisë dhe pajisja me certifikatë performancë të energjisë së ndërtesave është një detyrim ligjor që duhet zbatuar”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Studio Services K-SA” SHPK se: “Në dokumentat e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit të specifikimeve të tenderit ka parregullsi në pikën 2.3.4.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij ose të ketë kontratë bashkëpunimi të vlefshme për inxhinierët dhe ekspertët e mëposhtëm:

- 1 (një) Ekspert Auditues Energjetike që disponon Certifikatë për Audituesin Energjetikë me kategorinë “Auditues Energjitik në Ndërtesa” të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Agjencia për Efikasitetin e Energjisë).

Argumentimi: Kjo pikë nevojitet për Projektin e Efikasitetit të Energjisë së godinës, (magazinës).

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara.

Është e vërtetë që nevojitet për projektin e Efikasitetit të Energjisë së godinës, por nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë parashikuar një sërë detyrimesh ligjore të cilat ndikojnë si në fondin limit ose në dhënien e ofertës ekonomike nga ana e operatorëve ekonomikë pse:

1. Autoriteti kontraktor duhet të paraqiste detyrën e projektimit.
2. Autoriteti kontraktor duhet të paraqesi sa metra katrorë është objekti magazinë.
3. Autoriteti kontraktor duhet të ketë parasysh që auditimi energjitik ka vlerat e saj të shërbimit që rregullohet me ligj të veçantë: Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Ligji nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”, i ndryshuar, Rregullore e miratuar me Urdhërin nr. 5, datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores “Për formatimin e auditimit energjitik dhe pagesa për audituesin energjitik.”

Autoriteti kontraktor ka parashikuar që oferta duhet të jetë në zbatim të Operatori ekonomik ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me nr. 5585 prot., datë

25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Kjo kërkesë nuk përputhet me ofrimin e shërbimit pasi kemi dy shërbime të cilat rregullohen nga legjislacioni i vecantë sepse:

1. Projektimi rregullohet me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.
2. Kurse Auditimi Energjistik me ligjin nr. 124/2015 “Për eficientësin e energjisë”, i ndryshuar, Rregullore e miratuar me Urdhërin nr. 5, datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores “Për formatimin e auditimit energjistik dhe pagesa për audituesin energjistik.”

Shëmbull: Ligji nr. 124/2015 “Për eficientësin e energjisë”, i ndryshuar, Rregullore e miratuar me Urdhërin nr.5, datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores “Për formatimin e auditimit energjistik dhe pagesa për audituesin energjistik”, kemi që:

- Në rast se magazina do të jetë 3000 m² x 250 lekë tarifa për metër katror = 750.000 lekë tek jo vlerë është 20 % taksa shteti jo TVSH = 150.000 lekë vetëm shërbim i auditimit.

Kreu III

Pagesa e audituesit energjistik

Neni 16

Pagesa e audituesit energjistik

1. Pagesa për audituesin energjistik që kryen auditimin e energjisë në ndërtesa dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë përcaktohet sipas tabelës në shtojcën 4 të kësaj rregullore.
2. Audituesi i energjisë paguan tek Agjencia përgjegjëse për Eficientësin e Energjisë 20% të vlerës së cdo certifikate (pa TVSH).

Shtojca 4

Pagesa e audituesit

Sipërfaqja e ndërtesës së audituar	Cmimi (pa TVSH)
0-120 m ²	30,000 lekë
121-250 m ²	330 lekë/m ²
251-500 m ²	300 lekë/m ²
501-1000 m ²	270 lekë/m ²
Mbi 1000 m ²	250 lekë/m ²

Pra kemi:

1. Parregullsi të fondit limit.

2. Parregullsi në mënyrën se si duhet të përgatitet oferta ekonomike pasi kemi ligje dhe akte në zbatim të ligjeve që rregullojnë mënyrën e shërbimeve specifike.
 3. Në bazë të ligjit nr. 124/2015 “Për eficientësin e energjisë”, i ndryshuar, Rregullore e miratuar me Urdhërin nr.5, datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores “Për formatimin e auditimit energjistik dhe pagesa për audituesin energjistik”.
- AK ka detyrimin që në momentin e hartimit të buxhetit për vitin 2021, në momentin që kanë hartim projektsh duhet të parashikojnë fondin për auditimin energjistik të objekteve.

Pra kemi:

1. Parregullsi të fondit limit.
2. Parregullsi në mënyrën se si duhet të përgatitet oferta.
3. Në bazë të ligjit nr. 124/2015 “Për eficientësin e energjisë”, i ndryshuar, Rregullore e miratuar me Urdhërin nr.5, datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores “Për formatimin e auditimit energjistik dhe pagesa për audituesin energjistik” dhe Pagesa Për Audituesin Energjistik kanë detyrim që në momentin e hartimit të buxhetit për vitin 2021, në momentin që kanë hartim projektsh duhet të parashikojnë fondin për auditimin energjistik. Gjithashtu kjo e bën më të rëndë situatën pasi me ligj AK duhet të auditojë stokun e objekteve që disponon.

Pra ne kërkojmë:

1. Modifikimin e DST, duke përcaktuar detyrën e projektimit dhe sa metar katrorë është magazina.
2. Përcatimin e fondit limit për shërbimin e projektimit më vete.
3. Përcaktimin e fondit për shërbimin e Auditimit Energjistik nëse shërbimi do të prokurohet si një i vetëm.
4. Por në rast se të dy shërbimet e tejkalojnë fondin e parashikuar nga AK, kërkojmë anulimin e procedurës dhe prokurimin veçmas të Projektit dhe Auditimit.
5. Shërbimi i Auditimit Energjistik të veçohet si shërbim pasi ka tarifën e saj të shërbimit dhe taksohet në bazë të metrave katrorë $\times 20\%$ të vlerës totale nga shteti mbi bazën e Urdhërit nr.5, datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores “Për formatimin e auditimit energjistik dhe pagesa për audituesin energjistik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 11, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Aftësitë teknike dhe profesionale” pika 2.3.4, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij ose të ketë kontratë bashkëpunimi të vlefshme për inxhinierët dhe ekspertët e mëposhtëm:

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf, që disponon licencë profesionale të vlefshme për “PROJEKTUES GJEODET” me kategoritë:
 - 8/a rilevime inxhinierike;

- 1 (një) Inxhinier Elektrik, që disponon licencë profesionale të vlefshme për “PROJEKTUES INSTALATOR” me kategoritë:
 - 4/c - Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;
 - 4/j - Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik, që disponon licencë profesionale të vlefshme për “PROJEKTUES INSTALATOR” me kategoritë:
 - 4/b -Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme;
 - 4/ f - Projektim të sistemeve kundra zjarrit;
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog, që disponon licencë profesionale të vlefshme për “STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK” me kategoritë:
 - 9/a: Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile –ekonomike deri në 5 kate;
 - 9/d Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët;
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik, që disponon licencë profesionale të vlefshme për “PROJEKTUES VEPPRA HIDRAULIKE” me kategoritë:
 - 5/c - Ujësjellës-kanalizime urbane – rurale;
- 1 (një) Ekspert Mjedisor për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis që disponon Certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të lëshuar nga organet Kompetente sipas ligjeve në fuqi dhe Licencë me kodin III.2.A “Shërbim ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” të lëshuar nga QKL.
- 1 (një) Ekspert Zjarrfikës që disponon Certifikatë për ushtrimin e profesionit si ekspert zjarrfikës privat të lëshuar nga institucionet përkatëse Ministria e Brendshme, Drejtoria MZSH, dhe Licencë me kodin I.2.A “Shërbim ekspertize për MNZSH ” të lëshuar nga QKL.
- **1 (një) Ekspert Auditues Energjetike që disponon Certifikatë për Audituesin Energjetikë me kategorinë “Auditues Energjitik në Ndërtesa” të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Agjencia për Efiçencën e Energjisë).**

Për stafin e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Diplomë
- b. CV (Preferohet të ketë realizuar projekte ose ekspertiza në fushën përkatëse sipas detyrës së projektimit)
- c. Kontratë të vlefshme pune ose bashkëpunimi
- d. Licencë dhe Certifikatë përkatëse të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.
- e. Deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Pikat e licencave apo certifikimeve që nuk trajtohen në V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016 duhet të jenë në përputhje me V.K.M. Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, V.K.M. Nr. 407 date 19.06.2019 “për

miratimin e procedurës, te kategorive, kushteve, kërkesave te kualifikimit dhe te eksperiencës profesionale për personin, te cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik” dhe akteve nënligjore në fuqi.

III.1.2. Në pikën 1, të nenit 50 “Shërbimi i konsulencës” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese”.

Në nenin 77, pikat 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në pikën 5, të nenit 54 “Shërbim konsulence” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se: “Njoftimi i kontratës për shërbimin e konsulencës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike. Ky njoftim përshkruan nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, karakteristikat e kontratës dhe kriteret minimale të përzgjedhjes së kandidatëve. Njësia e prokurimit apo edhe struktura të specializuara duhet të hartojnë projektkontratën me përkufizime të qarta të objektivave, qëllimeve dhe të synimit të detyrës në fjalë dhe dokumentet e tenderit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti/enti kontraktor”.

III.1.3. Në nenin 16 “Auditimi energjetik” të Ligjit nr. 124/2015 “Për eficientësinë e energjisë” ku parashikohet ndër të tjera: “1. Auditimet energjetike kryhen nga auditues energjie të

licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë.

2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse.

3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm.

4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Efikasitetin e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.

6. Çdo person juridik që kategorizohet si konsumator i madh energjie dhe është subjekt i auditimit të detyrueshëm, duhet që, brenda dy vjetësh nga marrja e rezultateve të auditimit, të ndërmarrë masat dhe kryejë veprimet e rekomanduara për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

7. Personat fizikë ose juridikë, subjekt i auditimit energjetik, paguajnë shpenzimet e kryera nga audituesi, si dhe shpenzimet për zbatimin e masave të dhëna nga audituesi për kursimin e energjisë.

8. Format i auditimit energjetik dhe pagesa për audituesin energjetik përcaktohen në rregulloren e hartuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë dhe të miratuar nga ministri dhe ministri përgjegjës për ndërtimin.

Në nenin 25 “Agjencia për Efikasitetin e Energjisë” pika 3, gërma “i” parashikon se: “3. Agjencia është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për efikasitetin e energjisë dhe ka detyrat e mëposhtme: i) të këshillojë autoritetet e administratës publike vendore, administratorët e ndërtesave publike dhe atyre me destinacion banimi për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të efikasitetit të energjisë;

Ndërsa në pikat 1 dhe 2 të nenit 10 “Certifikimi i performancës së energjisë së ndërtesave” të Ligjit nr. 116/20216 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” ku parashikohet ndër të tjera: “1. Certifikimi i performancës së energjisë së ndërtesave duhet të jetë i detyrueshëm për:

- a) të gjitha ndërtesat ose njësitë e ndërtesave, të cilat do të shiten ose do të jepen me qira;
- b) të gjitha ndërtesat, të cilat do të ndërtohen ose do t'i nënshtrohen rinovimit të rëndësishëm;
- c) të gjitha ndërtesat që janë në përdorim nga një autoritet publik ose nga institucionet që sigurojnë një shërbim ndaj publikut dhe që frekuentohen shpesh nga publiku, të cilat kanë një sipërfaqe të shfrytëzueshme mbi 500 m². Duke filluar nga data 9 korrik 2018, kërkesa për kufirin e mësipërm të sipërfaqes së shfrytëzueshme do të zvogëlohet në 250 m². Në këtë rast, certifikatat e performancës së energjisë duhet të vendosen në vende qartësisht të dukshme nga publiku.

2. Kur një ndërtesë ose njësi ndërtese shitet ose jepet me qira përpara se ajo të jetë ndërtuar, pronari i ndërtesës duhet që në fazën e projektimit të pajisë me certifikata të përkohshme të performancës së energjisë këto ndërtesa ose njësi ndërtesash. Me përfundimin e punimeve të ndërtimit, këto ndërtesa ose njësi ndërtesash pajisen me “Certifikatën për performancën e energjisë” për qëllime të lejes së përdorimit.

Në pikën 1 të Kreut I të VKM Nr. 958, datë 02.12.2020 “Për procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës energjitike të ndërtesave dhe të modelit, përmbajtjes e kushteve të regjistrimit të “Certifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave” parashikon se: “1. Ky vendim e shtrin fushën e zbatimit vetëm në ndërtesat dhe në njësitë e ndërtesave të referuara në pikën 1, të nenit 10, të ligjit nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, sipas kategorive të përcaktuara me ligj”.

Në pikën 2 të Kreut II të VKM Nr. 958, datë 02.12.2020, parashikohet se: “II. Procedurat e certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave 1. Çdo subjekt që ka në pronësi ose administrim një ndërtesë, për të cilën është i detyrueshëm certifikimi i performancës së energjisë, zgjedh një auditues energjie nga Regjistri i Audituesve Energjetik të certifikuar, të publikuar në faqen zyrtare të agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë”.

Ndërsa në nenin 16 “Pagesa e audituesit energjitik” të Urdhërit nr. 05, datë 12.01.2021 parashikohet se: “1. Pagesa për audituesin e energjisë që kryen auditimin e energjisë në ndërtesa dhe lëshon certifikatën e performances së energjisë përcaktohet sipas tabelës në shtojcën 4 të kësaj rregullore.

2. Audituesi i Energjisë pagan tek Agjencia përgjegjëse për Eficiencën e Energjisë 20% të vlerës së çdo certifikate (pa TVSH)”.

Ndërsa në pikën 2 të nenit 17 të Urdhërit nr. 05, datë 12.01.2021 parashikohet se: “Raporti i auditimit Energjetik për ndërtesat e reja dhe ndërtesat në fazë projektimi duhet të shoqërojë certifikatën e performancës së energjisë në ndërtesat e reja ose certifikatën paraprake të performancës së energjisë për ndërtesat në fazë projektimi”.

III.1.4. Me shkresën nr. 6506/1 prot., datë 18.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1433/7 prot., datë 19.10.2021 “Kthim përgjigje”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin ku ndër të tjera ka informuar se: *“Referuar kërkesës tuaj nëse është përfshirë pagesa e audituesit të energjisë që kryen auditimin dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë në strukturën e kostos së projekt-idesë sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” duke qenë se baza ligjore e certifikimit të audituesve të energjisë, miratimi i formatit të auditimit energjitik dhe pagesës për audituesit për ndërtesat në fazë projekt-ideje dhe atyre të ndërtuara, janë miratuar në një kohë të mëvonshme si dhe duke patur parasysh se implementimi i tyre ka filluar në vitin 2021, ju informojmë se **këto risi legjislative nuk kanë qenë parashikuar në VKM Nr. 354, datë 11.05.2016.** Për sa më sipër, sjellim në vemëndjen tuaj që aktet e sipërcituara, të miratuara në fushën e efikasitetit të energjisë dhe pajisja me certifikatë performance të energjisë së ndërtesave është një detyrim ligjor që duhet zbatuar”.*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Studio Services K-SA” SHPK ka të bëjë përkatësisht me pretendimet për rastin, *1 (një) Ekspert Auditues Energjetik Përcaktimin e fondit limit për shërbimin e projektimit më vete, Përcaktimin e fondit për shërbimin e auditimit Energjitik nëse shërbimi do të prokurohet si një i vetëm, por në rastin se, të dy shërbimet e tejkalojnë fondin e parashikuar nga AK kërkojmë anulimin e procedurës dhe prokurimin veçmas të projektit dhe auditimit.*

KPP gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje- me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e veçantë të vendosur.

Sikundër pasqyruar më sipër për një shqyrtim sa më të drejtë dhe transparent të pretendimeve të palës ankimuese, KPP gjykoi të nevojshme ti drejtohej Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duke kërkuar interpretim në lidhje me përfshirjen në pagesa e Audituesit të Energjisë, që kryen auditimin e energjisë dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë, në strukturën e kostos së projekt-idesë përfundimtare sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, për çështjen objekt shqyrtimi. Referuar interpretimit të dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6506/1 prot., datë 18.10.2021, protokolluar me

tonën me nr. 1433/7 prot., datë 19.10.2021 “Kthim përgjigje”, na informon se “Referuar kërkesës tuaj nëse është përfshirë pagesa e audituesit të energjisë që kryen auditimin dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë në strukturën e kostos së projekt-idesë sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” duke qenë se baza ligjore e certifikimit të audituesve të energjisë, miratimi i formatit të auditimit energjitik dhe pagesës për audituesit për ndërtesat në fazë projekt-ideje dhe atyre të ndërtuara, janë miratuar në një kohë të mëvonshme si dhe duke pasur parasysh se implementimi i tyre ka filluar në vitin 2021, ju informojmë se këto risi legjislative nuk kanë qenë parashikuar në VKM Nr. 354, datë 11.05.2016”.

Por, referuar dokumenteve standarde të tenderit të hartuara nga autoriteti kontaktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, është kërkuar që “ofertuesit në përlllogaritjen e ofertës duhet t’i referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Gjithashtu, sipas Vendimit me Nr. 467/13 prot., datë 06.08.2021 të hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), ka argumentuar se “ në bazë të VKM nr. 354, datë 11.05.2016, kreu III, seksioni 1, neni 25, faza III, “Projekt ideja përfundimtare (sistemet e planifikimit të integruar) pika (i) a thuhet: “Përpunimi i konceptit të projektit (përpunim hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin energjitik të rinovueshme) dhe kërkesat mjedisore ose të zhvillimit të qëndrueshëm duke vënë në përdorim ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, dhe kompletimin e projekt-idesë përfundimtare”. Pra, projekti i efikasitetit përfshihet në miratimin e projekt-idesë përfundimtare (certifikata paraprake e performancës së energjisë për ndërtesat, në fazë projektimi, neni 17 i Rregullores Nr. 05, datë 12.01.2021 për Formatin e Auditimit Energjitik dhe pagesën e audituesit energjitik) proces i përcaktuar nga Enti prokurues në fazat e dorëzimit të projektit.

Referuar dispozitës ligjore në fushën e projektimit, konkretisht VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, KPP sqaron se, autoriteti kontraktor për përlllogaritjen e fondit për shërbimet e parashikuara të kërkuara sipas shtojcës 10 të dokumenteve të tenderit “Termat e referencës”, duhet të ketë në konsideratë normat e lejuara, në varësi të kategorisë dhe grupit tarifar, ku bën pjesë objekti i prokurimit.

Gjithashtu, referuar dispozitave ligjore dhe nënligjore përkatëse të cituara në fushën e auditimit energjitik, autoriteti kontraktor për përlllogaritjen e fondit, konkretisht për shërbimin

e hartimit të raportit paraprak të efikasitetit të energjisë shoqëruar nga certifikata paraprake e performancës së energjisë (në fazën e projektimit), autoriteti kontraktor duhet të respektojë dhe të ketë në konsideratë parashikimet ligjore, akteve nënligjore të miratuara si dhe Rregullores Nr. 05, datë 12.01.2021 “Për formatin e auditimit energjitik dhe pagesën e audituesit energjitik), sipas së cilës, pagesa për audituesin e energjisë që kryen auditimin e energjisë në ndërtesa dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë, do të kryhet sipas tabelës në shtojcën 4 të kësaj rregullore. Për sa i përket tarifës që paguhet pranë Agjencisë së Efikasitetit të Energjisë (AEE), përgjegjës për pagesën e kësaj tarife është audituesi i energjisë.

Për sa është parashtruar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, autoriteti kontraktor e ka parë të domosdoshme vendosjen e një Audituesi të Energjisë në fazën e projektimit, pasi është personi përgjegjës për hartimin e raportit paraprak të efikasitetit të energjisë shoqëruar nga certifikata paraprake e performancës së energjisë (në fazën e projektimit). Referuar korrespondencës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas së cilës ka konfirmuar që pagesa e audituesit të energjisë që kryen auditimin dhe lëshon certifikatën e performancës së energjisë nuk është e përfshirë në strukturën e kostos së projekt-idesë sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, pasi risitë legjislative mbi certifikimin e audituesve të energjisë, miratimi i formatit të auditimit të energjisë dhe pagesa e audituesit për ndërtesa në fazë projekt-ideje dhe ato të ndërtuara, janë miratuar në një kohë të mëvonshme. Ndërkohë, autoriteti kontraktor ka pranuar që ka kryer përlllogaritjen e fondit limit të procedurës objekt-ankimi sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016. Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të ripërlllogarisë përsëri fondin limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për të dyja këto shërbime, sipas konstatimeve të bëra më sipër. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të ligjit të prokurimit publik. Gjithashtu, është në diskrecionin e autoritetit kontraktor, për mënyrën, se si do të prokurojë shërbimin e konsulencës së kërkuar për objektin “*Studim-projektim "Punime ndërtimore dhe infrastrukture në varrezat publike Sharrë dhe Tufinë"*” sipas termave të referencës së hartuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor të marrë masa për ripërlllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sipas konstatimeve të sipërcituara, duke përfshirë në përlllogaritjen edhe shërbimin e Audituesit të Energjisë, për sa kohë në VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, nuk ka qenë e parashikuar në strukturën e kostos së projekt-idesë përfundimtare të kësaj VKM.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “*Autoriteti kontraktor duhet të paraqiste detyrën e projektimit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Nga kontrolli i dokumenteve të tenderit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, detyra e projektimit është përfshirë në shtojcën 10 “Formulari i termave të referencës”, “Detyrë projektimi – Punime ndërtimore dhe infrastrukturore në varrezat publike Sharrë dhe Tufinë”.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: *“Autoriteti kontraktor duhet të paraqesë sa metra katrorë është objekti magazinë”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje, shkresës kthim-përgjigjeje me Vendimin me Nr. 467/13 prot., datë 06.08.2021 të autoritetit kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe justifikimin për vendosjen e tyre, ka sqaruar ankimuesin në mënyrë shteruese lidhur me pretendimin e ankimuesit për këtë pikë, por duhet të bëjë dhe publikimin e ndryshimeve përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 75 të LPP, i cili, parashikon shprehimisht se: *“Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës [...]”*, me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë ankimues me ndryshimet për dokumentet e tenderit, për të qenë i qartë e i saktë për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK për procedurën e prokurimit me Nr. REF-01814-07-28-2021 me objekt: *“Studim-projektim Punime ndërtimore dhe infrastrukture në varrezat publike Sharrë dhe Tufinë”*, me fond limit 1 249 958,6 (një milion e dyqind e dyzetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë presje gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale.

2. Autoriteti kontraktor të ripërlllogarisë fondin limit të procedurës objekt ankimi sipas konstatimeve të mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Studio Services K-SA” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro